



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.01.2017
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Dhjetor 01.12.2016-31.12.2016

DKA e Arsimit në Lipjan edhe gjatë muajit Dhjetor ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme:

Është lidhur Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe organizatës VORAE me qëllim të bashkëpunimit me projektin “**Përfshirja Sociale**” dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe grupe të tjera në Komunë.

Ka vazhduar trajnimi për mësimdhënësit e shkollave fillore - Mësues klase (1-5) për lëndët: Matematikë dhe Shkencat e Natyrës.

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për fillimin e procedurave - furnizim me ushqim dhe pije (kontratë kornizë).

Kërkesë Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për paisjen e bibliotekave me libra shkollor.

Përfundimi i gjysëm vjetorit të parë për parafillorët, klasa 1-9 dhe klasa 10-12.

Përfundimi i ndërtimit të shkollës Shfmu “Emin Duraku” në Banullë, p.n.f në Bujari.

Pjesëmarrja e zyrtarit për financa në trajnimin për vlerësimin e performancës së Komunës.

Përfundimi i shpenzimeve në kategorinë mallra/shërbime dhe komunal.

Planifikimi i buxhetit për departamentin e prokurimit.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.